

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Auto Servis Olti" Shpk

Sot, më datë 17/07/2018, une i poshtëshënuari:

- **Z. OLTION MIHALI**, shtetas shqiptar, i biri i MINA, lindur më 23.04.1989 në LUSHNJE dhe banues në Tiranë, Mbajtes I kartes se identitetit me Nr. Personal. I90423030E;

në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kam vendosur të krijoj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "*Auto Servis Olti*" Shpk (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është "*Auto Servis Olti*" Shpk.

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Tirane me Adrese **Rruga Anri Buasen, Ambjent nje kat, ZK.3321, Nr. Pasurie. 433/123, Sharre-Tirane**

Neni 3

- 3.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa kufizim.
- 3.2. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4

4.1. Objekti i Shoqërisë është si vijon:

- Sherbime te ndryshme kryesisht ne fushen automekanike dhe elektromekanike
- Shit-blerje (tregti) te produkteve te ndryshme te çfardoshme qofshin ato si:



7. Pjese kembimi per automjete

8. Vaj

9. Filtra

10. cdo produkt tjeter qe ka lidhje me kete lloj fushe ose ne fusha te tjera.

11. Makina me qera

12. Etj...

- Import - eksport dhe tregtim brenda dhe jasht vendit të automjeteve te ndryshem
- Konsulencë në fushën e Automekanike , Elektromekanike etj..
- Tregtim produkteve dhe shërbimeve të mësipërme drejtpërdrejt tek klientët ose on-line në internet (e-commerce).

4.2. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.

4.3. Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me, shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

4.4. Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti lidhur me, si rezultati, apo që ka lidhje me objektin e saj.

Neni 5

5.1. Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqint mijë) lekë.

5.2. Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuot kapitali, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara, me vlerën prej 100.000 (njëmijë) lekë secila.

Neni 6

6.1. Derdhja e kuotave të kapitalit themeltar është bërë në mënyrën e mëposhtme:

- Z. Oltion Mihali ka derdhur në para shumën prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 7

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara nga neni 12 i Statutit.

Neni 8

- 8.1. Shoqëria administrohet nga administratori. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë, për një periudhë të pacaktuar, me të drejtë ripërtëritjeje.
- 8.2. **Nëpërmjet këtij akti, emërohet Administrator Z. Oltion Mihali për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.**
- 8.3. Administratori ka të drejtë të veprjë, personalisht ose duke i deleguar personave të tretë, lidhur me të gjitha procedurat për regjistrimin e Shoqërisë si person juridik pranë organit kompetent. Ai është i autorizuar të veprjë për llogari të Shoqërisë deri sa regjistrimi i saj të ketë përfunduar.
- 8.4. Administratorit të sipërpërmëndur i jepen të gjitha të drejtat e administrimit, të zakonshëm e të jashtëzakonshëm, duke përfshirë edhe nënshkrimin dhe ekzekutimin e të gjitha akteve në emër dhe për llogari të Shoqërisë dhe ai mund të delegojnë pushtetin e tij tek persona të tretë, me prokura të posaçme të noterizuara.

**ADMINISTRATORI I PERSONIT JURIDIK
" Auto Servis Olti " SHPK**

Lexuar, nënshkruar

OLTION MIHALI
Z. OLTION MIHALI



Tiranë / 17. 07. 2018